

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### KAPACITETET TEKNIKE

Të gjitha riparimet duhet të kryhen me cilësi të lartë dhe përgjegjshmeri sic kërkohet ne Specifiket e mëposhtme dhe Termat e References.

Operatori ekonomik duhet garantojë riparimin dhe shërbimin në kohë dhe me cilësi të automjeteve nëpërmjet një stafi të kompletuar dhe të specializuar bashkëkohor të punonjësve per kete qellim OE duhet te plotesoje kushtet:

- a) Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar – Qershor 2016 e shoqeruar me listpagesat (formularet E-sig 025 per kete periudhe) .
- b) Operatori ekonomik duhet te vertetoje qe ka ne stafin e vete te punesuar
  - 1 (një) inxhinierë mekanik i cili të jetë i përfshirë në formularin E-sig 025 te kerkuar ne piken a)
  - 10 mekanike te specializuar ne riparimin e automjeteve te përfshirë ne formularin E-sig 025 te kerkuar ne piken a)
- c) Operatori ekonomik duhet te kete makineri pajisje te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:
  - Jo më pak se 4 (katër) ura ngritëse (me kapacitet jo më pak se 3Ton) për automjetet;
  - Repart kontrolli teknik të pajisur me urën përkatëse për ngritje dhe kontroll të mjetit ;
  - Pajisje diagnostikuese të difektit në automjet ;
  - Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit ;
  - Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit ;
  - Pajisje për kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) në sistemin e drejtimit ;
  - Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit ;
  - Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave automjetit (ballancimi rrotave) ;
  - Pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v;
  - Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergencës) së rrotave të mjetit ;
  - Pajisje për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit ;
  - Pajisje për venien në fazë të motorrit të mjetit ;
  - Pajisje për testimin e sistemit të ftohjes ;
  - Pajisje për mbushjen e kondicionerëve të automjeteve me gaz ;
  - Pajisje me sistem të ndërrimit të vajit të automjeteve nëpërmjet aspirimit të vajit nga ; motorri (pa hequr tapën e vajit nga sotokarteri) ;
- d) Operatori ekonomik duhet të ketë karroatrec në pronësi ose me qera për transportimin e automjeteve me defekt, për të cilin duhet të paraqesë një dëshmi pronësie ose kontratë noteriale qeraje. Ne momentin qe ndodhin defekte per te cilat operatori ekonomik do te njoftohet se eshte e nevojshme transportimi i mjetit me karroatrec, operatori ekonomik te paraqitet ne vendodhjen e Automjetit ne ate moment.

- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, ambient për ushtrimin e aktivitet të tij (lidhur me riparimin e automjeteve) brenda një rreze prej 30 km nga Spitali Rajonal Durrës. Ne lidhje me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqese aktin e pronesisë ose nese e ka me qira, kontraten e qirase të objektit ne vendodhjen e sipërpermendur. Ky vend ushtrimi aktiviteti nga ana e operatorit duhet të jete i pasqyruar ne Ekstraktin Historik te Rregjistrit Tregtar per te dhenat e Subjektit.
- f) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar përsa i përket: Sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008 për aktivitetin lidhur me shërbimin dhe riparimin e automjeteve, si dhe kontrollit teknik të automjeteve.
- g) Me qëllim lidhje kontrate do të kerkohet siguracion profesional sic specifikohet ne Kushtet e Pergjithshme te Kontrates(Shtojca 16 e DST)

